



| | | | |
|------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Pamirëno / Prodato Received / Delivered | 04.07.2022 | 2 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKDMSHICK | 3898/2022 | | 1/1 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.492/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.492/2022 të datës 31.05.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi kundër organit të punësimit,

Agjencia për Informim dhe Privatësi në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 04.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.492/2022 e datës 31.05.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.03/2022 i datës 14.03.2022 i Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.
- III. Shfuqizohet Vendimi me numër Nr.03/01/2022 i datës 24.05.2022 i Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 31.05.2022 ka parashtrua ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me numër protokollit 3168/22 e regjistruar nën shenjën A.nr.492/2022, kundër Vendimit me Nr.03/01/2022 të datës 24.05.2022 të Menaxheres së Njësies së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, shkeljeve procedurale dhe vlerësimit të gabuar, jo real dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 07.06.2022 ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, ndërsa kjo e fundit më datë 21.06.2022 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.492/2022 e datës 31.05.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.03/01/2022 të datës 24.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3303/2022 të datës 07.06.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 3593/2022 të datës 21.06.2022; Njoftimin me numër të protokollit 3004/2022 të datës 24.05.2022; Ankesën A. nr. 287/2022 të datës 28.03.2022, të parashtruar nga ankuesja me numër protokollit 1616/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-malin e datës 21.03.2022; E-mailin e datës 17.03.2022; E-malin e datës 14.03.2022; Vendimin me numër 03/2022 të datës 14.03.2022; Dëshminë për masën disiplinore të datës 25.02.2022; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Vendimin me NR.23/2020 të datës 21.04.2020; Vendimin me numër 53/2020 të datës 10.07.2020; Flete rekomandimin e datës 31.12.2011; Vërtetimin e datës 10.05.2016; Referencën e datës 06.02.2010; Vendimin me numër ZK-60/12 të datës 12.11.2012; Vendimin me numër 05/2014 të datës 18.12.2014; Vendimin me numër 04/2014 të datës 29.09.2014; Akt emërimit të datës 07.12.2011 të anketueses; E-malin e datës 17.03.2022; Certifikatën e datës 02.05.2018; Certifikatën e datës, 22-11.2017; Certifikatën e datës 15-15 Dhjetor.2016; Certifikatën e datës 03.11.2016; Certifikatën e datës 20-21 Prill.2015; Certifikatën e datës 17.01.2016; Certifikatën e datës (numri i pa dukshëm); Certifikatën e datës 13-15 qershor.2013; Certifikatën e datës 07-08 maj 2012; Certifikatën e datës 26-27 prill 2021; Certifikatën e datës 17/1 dhjetor 2012; Certifikatën 12.03.2012; Certifikatën e datës 14.01.2002; Certifikatën e datës 27.05.2002; Certifikatën e datës 05.08.2004; Referencën e datës 01.04.2016; Letër Referencën e datës 28.08.2015; Diplomën me NR.898 të datës 28.04.2004 me të cilën ankuesja mori titullin Jurist i Diplomuar; Provën shtesë të datës 05.04.2022 me numër të protokollit 1865/2022; E-mailin e datës 25.03.2022; E-mailin e datës 23.05.2016; E-mailin e datës 30.05.2016; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.03.2022 me numër të protokollit 1769/2022; Përgjigjen në ankesë të datës 12.04.2022 me numër të protokollit 2022/2022; Aplikacionin e ankueses të datës 25.02.2022; Konkursin me numër reference RN00008191 të datës 24.04.2022; Vërtetimin e datës 10.05.2016; Flete rekomandimin e datës 31.12.2011; Vendimin me numër 23/2020 të datës 21.04.2020; Vendimin me numër Nr. 03/2020 të datës 14.03.2022; Vendimin me Nr.04-V-476 të datës 08.11.2012;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankueses është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur së Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi me datë 25.01.2022 ka shpallur Njoftimin për Konkursin me numër reference RN0001662 për pozitën e punës " Drejtor i Përgjithshëm", e në të cilin ka aplikuar edhe ankuesja sipas aplikacionit të datës 25.02.2022 me numër kodit RAN0003121.

Në fazën e vlerësimit të aplikacioneve të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi me Vendimin Nr.03/2022 të datës 14.03.2022, ka refuzuar aplikacionin e ankueses, me arsyetimin së e njëjta nuk ka plotësuar kriteret e konkursit gjegjësisht nuk ka përvojën e kërkuara menaxheriale. E pakënaqur me refuzimin e aplikacionit, ankuesja përmes emailit të datës

17.03.2022 i është drejtuar me kërkesë Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi lidhur me rishqyrtimin e dokumentacionit të aplikimit, ndërsa sipas Vendimit të Këshillit me numër A.nr.287/2022 të datës 05.05.2022, Menaxherja e Burimeve Njerëzore me Vendimin me numër 03/01/2022 të datës 24.05.2022 ka hedhur poshtë ankesën si të jashtë afatshme.

Në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja pretendon së vendimi i kundërshtuar është përshirë me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, shkelje procedurale dhe vlerësim të gabuar, jo real dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Me tej pretendon së e njëjta ka plotësuar të gjitha kriteret e konkursit duke përfshirë edhe përvojën e kërkuar. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloi vendimin e atakuar si dhe të obligoj Komisioneren e Agjencisë për Informim dhe Privatësi që të ndërmerr të gjitha veprimet për zhvillimin e procedurës së rekrutimit në pajtim me ligjin.

Kolegji i Këshillit nga vlerësimi i shkresave të lëndës ka konstatuar që Menaxherja e Burimeve Njerëzore përmes emailit të datës 14.03.2022 ka përcjell të ankuesja Vendimin me numër 03/2022 për refuzimin e aplikacionit, ndërsa ankuesja me datë 17.03.2022 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të aplikacionit, e mbi këtë bazë, Kolegji i Këshilli vlerëson së Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.03/01/2022 të datës 24.05.2022 nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë ka zbatuar gabimisht dispozitat materiale, pasi që bazuar si me lartë ankesa e ankueses kundër vendimit për refuzim të aplikacionit është parashtruar brenda afatit ligjor respektivisht brenda afatit të përcaktuar me nenin 8 paragrafi 6 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranim, Vlerësim dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë ku parashihet se: *Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë ose të paraqiten pranë kësaj Njësie për t'u njohur me arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurrim të mëtejshëm, andaj mbi këto arsye Kolegji ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesja me rastin e aplikimit për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm" dhe si rrjedhojë ka konstatuar se ankuesja sipas Diplomës me Nr.898 të datës 08.11.2004 ka përfunduar studimet me datë 28.04.2004 në Fakultetin Juridik, ndërsa përkitazi me përvojën e punës dhe bazuar në dëshmitë e ofruara nga ankuesja rezulton se: sipas Vërtetimit të datës 10.05.2016 të lëshuara nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vërtetohet së ankuesja ka punuar në këtë institucion nga data 28.09.2009 deri me 31.08.2010 si Trajnere në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, kurse nga data 27.10.2010 deri me 28.02.2011 ka punuar si Udhëheqëse e Ndërrimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve; sipas shkesës së datës 31.12.2011 të lëshuar nga Drejtori i Zyrës së Regjistrimit të Popullsisë është konfirmuar së ankuesja ka punuar në këtë Zyrë si Mbikëqyrëse për periudhën nga data 05.03.2011 duke mos u specifikuar saktë kohëzgjatja e marrëdhënies së punës në këtë pozite, ndërsa ankuesja nuk ka ofruar dëshmi tjetër shtesë lidhur me këtë përvojë punë (kontratë punë apo vërtetim lidhur me pagesën e detyrimeve pensionale apo tatimore) kurse sipas Akt Emërimit të datës 07.12.2011 e njëjta është emëruar në pozitën "Zyrtarë Ligjorë" në Departamentin Ligjor në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve të cilën pozitë ende e ushton, ndërsa sipas Vendimit me numër Nr.23/2020 të datës 21.04.2020 dhe Vendimin Nn.53/2020 të datës 10.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Transfereve ankuesja është caktuar Zëvendësueses e Drejtorit të Departamentit Ligjor në Ministrinë e Financave dhe Transfereve e të cilën pozitë sipas konfirmimit të datës 05.05.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe

Transfereve, ankuesja e ka ushtruar nga data 21.04.2020 deri me datë 01.04.2021. Po ashtu nga provat e lëndës Kolegji ka gjetur edhe Vërtetimin Nr.03/1 të datës 18.10.2013 të lëshuar nga Drejtori i BSHE " Afarsiti" nga i cili rezulton se ankuesja ka punuar pranë këtij biznesi nga data 01.05.2003 fillimisht si Asistente Juridike, ndërsa nga data 28.04.2004 deri me 31.12.2011 në pozitën e Bashkëpunëtores Profesionale, rrjedhimisht bazuar në këto të gjetura dhe duke pas parasysh kriteret e përcaktuara me Konkursin me numër reference RN0001662 të datës 25.01.2022 për pozitën " Drejtor i Përgjithshëm 1 ku si kriteret të përgjithshme formale janë specifikuar *Diplomë/a të studimeve universitare : Fakulteti Juridik, ekonomik, apo administrate Publike me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Se paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale , duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese, Kolegji konstaton se ankuesja ka plotësuar kriterin e arsimimit dhe të përvojës profesionale tetë (8) vjeçare, mirëpo e njëjta nuk ka pesë (5) vite përvojë punë në pozitë drejtuese, andaj mbi këto arsye rezulton se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit.*

Bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson së Menaxherja e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr. 03/2022 i datës 14.03.2022 për refuzim të aplikacionit të ankueses duke vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 8 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranim, Vlerësim dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues i cili përcakton se: *1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme....".*

Siç u tha me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.492/2022

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Ilire Mehmeti-SHAQIRI
Proçesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuese;
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

